

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQERIA "Alba Skela Construction" SH. P. K

Adresa: Rr. "Dritan Hoxha" Nd 24 ,H I Tiranë

Date 18.08.2022

VENDIM ASAMBLEJE

Nr 5 DATE 18.8.2022

PËR

**"ZMADHIM I KAPITALIT THEMELTARE DHE KAKTIMI I AUDITUESIT LIGJOR PER VLERSIM
TE FITIMIT TE PASHPERNDARE**

Mbështetur në Nenin 81, pika 1/c,e,ë,pika 3/a,b te Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë Tregtare" I Ndryshuar, Nenin 43 te ligjit 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" I ndryshuar; Nenin 33/1 të Ligjit Nr 8438, datë 28.12.1998 "Tatimi mbi të ardhurat" I ndryshuar; Statutin e shoqërisë "Alba Skela"shpk; Në Tiranë,sot më datë 18.08.2022,në selinë e shoqërisë"Alba Skela Construction"shpk,u mbledh asambleja e ortakut te vetem të kësaj shoqërise,e cila pasi ka miratuar në mbledhjen e mëparshme të ortakëve të shoqërisë rezultatet financiare të vitit ushtrimor 2021,mori sot në shqyrtim në rendin e ditës.

Shqyrtimi i Veprimtarise Tregetare gjate vitit 2021,si dhe ecurine e saj ne te ardhmen .Ortaket e shoqerise tregetare "Alba Skela Construction " shpk Z.Mark Ndoj (ortak i vetem) pasi u njoh me rendin e dites .

VEREJTI SE

Shoqeria "Alba Skela "gjate ushtrimit 2021 dhe gjate viteve te kaluara ka patur rezultate te mira financiare.Gjate shqyrtimit te veprimtarise tregetare dhe te tregueseve financiare te shoqerise tregetare "Alba Skela "shpk Tirane ,Ortaku i vetem i saj konstatoi se per ecurine me te mire te shoqerise ne te ardhmen,per te pasur vashdimesi ,qendrueshmeri dhe siguri te veprimtarise,si dhe per te rritur besushmerine e saj ndaj institucioneve,ne baze te Statutit dhe Aktit te Themelimit te saj me fitimet e pashperndara dhe ate te ushtrimit ,sipas gjendjes se bilancit me 31.12.2021.

VENDOSI:

- 1- Zmadhimi i kapitalit themeltare te shoqerise "Alba Skela " shpk ,me fitimet e pa shperndara dhe ate te vitit 2021, gjendje me 31.12.2021.
- 2- Te caktoje Znj ,Erminda Gjondeda ,anetare i I.E.K A.me profesion Auditues Ligjor i Rregjisitruar me nr Licence 312 date 28.03.2014,per vleresimin e fitimit te pa shperndare te shoqerise,gjendje te dates 31.12.2021 me te cilen do te shtohet kapitali themeltare.
- 3- Për zbatimin e këtij vendimi dhe përcjelljen e tij në institucionet përkatëse ngarkohet përfaqësuesi ligjor i shoqërisë "Alba Skela Construction " shpk
- 4- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E ORTAKUT TE VETEM

MARK NDOJ

Mark Ndoj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA "Alba Skela Construction " SH. P. K

Adresa: Rr. "Dritan Hoxha"Nd 24,H 1 . Tiranë

Tirane 30.08.2022

VENDIM ASAMBLEJE
Nr 6. DATE 30.08.2022
PËR

"VLERESIMIN E FITIMIT TE PASHPERNDARE DHE ZMADHIMIN E KAPITALIT THEMELTARE "

Mbështetur në Nenin 81, pika 1/e,c,ë pika 3/a,b te Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për shoqëritë Tregtare", Nenin 43 te ligjit 9723,date 03.05.2007"Per Qendren Kombetare te Biznesit"l ndryshuar, Nenin 33/1 të Ligjit Nr 8438, datë 28.12.1998 "Tatimi mbi të ardhurat" l ndryshuar; Statutin i Shoqërisë "Alba Skela Construction " shpk;

Në Tiranë, sot më datë 30.08.2022 në selinë e shoqërisë "Alba Skela Construction" shpk,u mbledh asambleja e Ortakut të vetem te kësaj shoqërise,e cila pasi ka miratuar në mbledhjen e mëparshme të ortakëve të shoqërisë rezultatet financiare të vitit ushtrimor 2021, mori sot në shqyrtim në rendin e ditës,

Shqyrtim i Raportit te Audituesit Ligjor te dates 29.08.2022,pergatitur nga Znj .Erminda Gjondeda,per Vleresimin e fitimeve te pashperndara dhe fitimit te vitit ushtrimore 2021,te cilat do te perdoren per Zmadhimin e Kapitalit Themeltare te Shoqerise .

Asambleja e Ortakeve me pjesmarje te Z.Mark Ndoj ,Ortak i Vetem,pasi u njoh me rendin e dites :

VEREJTI SE :

1. Kapitali Themeltare i kesj shoqerie aktualisht eshte 83,000,000 leke .Ky kapital perbehet nga nje kuote dhe eshte i ndare ne kete menyre: Z.Mark Ndoj zoteron 100% te Kapitalit Themeltare te barabarte me 83,000,000 leke .
2. Me Vendimin Nr 4 date 05.07.2022,Asambleja e Ortakeve te Shoqerise ka proceduar konform dispozitive ligjore per shtesen e Kapitalit Themeltare,duke caktuar Znj.Erminda Gjondeda,Auditues Ligjor e pajisur me Licence Nr 312.date 28.03.2014,per vleresimin e fitimit te pashperndare te shoqerise,gjendje me date 31.12.2021 me te cilen do te shtohet kapitali themeltare.

Ne analize te rendit te dites :

Asambleja e ortakve te kesaj shoqerie,pasi njihet me Raportin e Audituesit Ligjor te dates 29/08/2022,pergatitur nga Znj,Erminda Gjondeda per vleresimin e fitimeve te pashperndara dhe fitimin e ushtrimit te vitit 2021,gjendje me 31.12.2021 me te cilin do te behet zmadhim i Kapitalit Themeltare te shoqerise ,veren se ky raport eshte i drejte ,ne perputhje me legjislacionin ne fuqi dhe per keto arsye duhet miratuar nga Asambleja e Ortakeve .

Sipas ketij raporti,Kapitali Themeltare i Shoqerise pas ketij zmadhimi ne shumen 30,000,000 leke behet nga 83,000,000 ne 113,000,000 leke .

Shtesa e Kapitalit Themeltare ne shumenn 30,000,000 leke dhe shtesa e rezervave ligjore ne shumen 2,000,000 leke do te realizohet me fitimet gjendje me 31.12.2021.Pas ketyre shtesave,fitimet e mbartura dhe ai i ushtrimit 2021 do te perdoren 100 % .

Per keto arsye , Asambleja e Ortakeve ,me votim unanim “

VENDOSI

- 1- Miratimin e Raportit te Audituesit Ligjor,date 29.08.2022 “Per Vleresimin e Fitimeve te Pashperndara me te cilat do te Zmadhohet Kapitali Themeltare i shoqerise,pergatitur nga Znj.Erminda Gjondeda .
- 2- Zmadhimin e Kapitalit Themeltare te kesaj shoqerie ne shumen 30,000,000 i cili pas kesaj shtese behet nga 83,000,000 ne 113,000,000 leke .
- 3- Zoterimi i Kapitalit Themeltare pas zmadhimit do te behehet ne kete menyre :
Z . Mark Ndoj 100 te kuotave ne kapital ,e barabarte me 113,000,000 leke .
- 4- Për zbatimin e këtij vendimi dhe përcjelljen e tij në institucionet përkatëse ngarkohet përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “Alba Skela Construction ” shpk
- 5- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ASAMBLEJA E ORTAKUT TE VETEM:

MARK NDOJ

Mark Ndoj



AUDITUES LIGJOR I RREGJSITRUAR

ERMINDA GJONDEDA

Nr licence 312 date 14.03.2014

RAPORT I AUDITUESIT LIGJOR

PER ZMADHIMIN E KAPITALIT

PER

SHOQERINE TREGTARE "ALBA SKELA CONSTRUCTION" SHPK

Per zmadhimin e kapitalit themeltare te shoqerise Alba Skela shpk

a) Me fitimet e pashperndara dhe ate gjendje me 31.12.2021

Permbajtja : Raporti i audituesit per zmadhim te kapitalit

Informacione te pergjithshme

Realizim i misionit ,procedure angazhimi .

Verifikim i zerave te bilancit

Konkluzione te pergjithshme

Bashkangjitur Raportit :

Vendim i Ortakut te Vetem te shoqerise Alba Skela Construction Nr 5 date
18.08.2022

Pasqyrat Financiare te ushtrimit te mbyllur me 31.12.2021



Drejtuar : ORTAKUT TE VETEM TE SHOQERISE
Alba Skela Construction shpk
RRUGA "DRITAN HOXH Nd 24 H,1 "
Tirane

Qellimi i angazhimit,

Asambleja e Ortakeve te shoqerise "Alba Skela Construction" shpk, Tirane me Vendimin Nr 5 date 18.08.2022, mbeshtetur ne nenin 81, pika 1/c, e, ë te ligjit Nr 9901, date 14.04.2008 "Per shoqerite tregtare" i ndryshuar, Neni 43 te ligjit 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit" i ndryshuar, Nenin 33/1 te Ligjit Nr 8438 date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat" i ndryshuar, Statutin e shoqerise Alba Skela Construction" shpk ka vendosur per:

- 1- Zmadhimin e Kapitalit Themeltare te shoqerise, me fitimet e pa shperndara dhe ate te vitit 2021, gjendje me 31.12.2021.
- 2- Emerimi, i Erminda Gjondedes, Auditues Ligjor per te kryer vleresimin e fitimeve te pa shperndara, gjendje me 31 Dhjetor 2021 qe do te shkojne per zmadhim te kapitalit themeltare te shoqerise .

Une kam kryer angazhimin tim ne perputhje me standartin nderkombetare te dhenjes se sigurise 3000, per te arritur nje nivel te arsyshem sigurie .

Pergjegjsia e Drejtimit

Drejtimi eshte pergjegjes per pergatitjen dhe paraqitjen e drejte ne perputhje me kerkesat ligjore te deklarimeve financiare, juridike dhe dhenjen e informacioneve te tjera te domosdoshme per dhenien e sigurise se procesit te zmadhimit te kapitalit per shoqerine Alba Skela Construction shpk .

Drejtimi eshte pergjegjes per paraqitjen e drejte dhe te sakte ne te gjitha aspektet materiale te Pasqyrave Financiare te mbyllura me 31.12.2021, dhe gjendjen e fitimit te pa shperndare me 31.12.2021.

Pergjegjsia e Auditusit Ligjor .

Pergjegjsia ime eshte te jap nje opinion mbi sigurine e procesit bazuar ne verifikimin e procedurave, te metodave te perdorura per zmadhimin e kapitalit te shoqerise si dhe pershtatshmerine e perdorimit te ketyre metodave .

Opinion, mbi vleresimin e fitimit te pa shperndare dhe ate qe eshte gjendje me 31.12.2021, sipas Pasqyrave Financiare te mbyllura me 31.12.2021.

Sipas opinionin tim, pas verifikimit te procedurave, si dhe ate te vleresimit te fitimeve te pa shperndara gjendje me 31.12.2021 rezultoi se rritja e kapitalit :

Nepermjet perfshirjes ne te, te fitimeve te pa shperndara gjendje me 31.12.2021 eshte sipas kuadrit ligjor.

Auditues ligjor

Erminda Gjondea



Tirane me 29.08.2022

Informacione te pergjithshme :

Alba skela Construction,eshte themeluar si shoqeri me pergjegjisi te kufizuar me date 12.01.2005 dhe eshte rregjistruar ne rregjistrin tregtare me date 17.01.2006,me ortak te vetem Z.Mark Ndoj me kapital fillestar te rregjistruar prej 100,000 leke .

Kapitali akutal i rregjistruar i shoqerise eshte 83,000,000 leke i perbere nga nje kuote dhe teresisht ne para i zoteruar nga Z.Mark Ndoj ortak i vetem.

Selia e shoqerise eshte me adrese Rruga "Dritan Hoxha"Nd 24 H,1 Tirane.Shoqeria Alba Skela Construction eshte e rregjistruar ne Degen e Tatimeve te rrethit Tirane me NIPT K481305490.

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte,ndertim,projektim,import,eksport,tregti te artikujve te ndryshem,sherbime dhe dhenje me qera etj

Drejtimi i shoqerise :Shoqeria ka nje administratore Z.Mark Ndoj .

• **Baza Ligjore per kryerjen e angazhimit ,**

- 1- Ligji Nr 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqerite tregtare "i ndryshuar
- 2- Ligji Nr 9723 date 03.05.2007,per QKB
- 3- Ligji Nr 8438 date 28.12.1998 "Per Tatimin Mbi te Ardhurat "i ndryshuar
- 4- Statutin dhe Aktin e Themelimit te Shoqerise Tregtare "Alba Skela Consruction "shpk Tirane
- 5- Vendimin Nr 5 date 29.08.2022 "te Asamblese se Ortakeve"te shoqerise tregtare "Alba Skela Construction shpk Tirane.

• **Dokumentacioni**

- Pasqyrat Financiare te vitit ushtrimore 2021"

• **Procedurat e mia te angazhimit perfshijne :**

1. Verifikimin e llogarive analitike si dhe kontrollin e llogarive specifike,parashikuar ne Ligjin Nr 9901 date 14.04.2008"Per tregtaret dhe shoqerite Tregtare"i ndryshuar,Ligji 10091 date 05.03.2009 per "Auditimin Ligjor organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te rregjistruar dhe kontabilistit te miratuar,Ligjit Nr 25/2018 date 10.05.2018"Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"i ndryshuar
2. Veifikimin e situates ekonomike financiare te shoqerise para momentit te zmadhimit te kapitalit.
3. Pergatitjen e raportit mbi verifikimin e procedurave per zmadhim te kapitalit te shoqerise,si dhe vleresimit te fitimit te pa shperndare gjendje me 31.12.2021 qe do te perdoret per zmadhim te kapitalit te shoqerise .
4. Veprimet kontabile per rritjen e kapitalit ne natyre nepermjet vleresimit te fitimeve te pa shperndara gjendje me 31.12.2021.

I- **Vleresimi I fitmeve te pashperndara,gjendje me 31.12.2021:**

Mbeshtetur ne PF -2021 ,kapitali I shoqerise perbehet :

Kapitali i Nënshkruar	23	83,000,000	83,000,000
▶ Primi i lidhur me kapitalin	24		
▶ Rezerva rivlerësimi	25		
▶ Rezerva të tjera	26		
1 Rezerva ligjore	26.1		
2 Rezerva statutore	26.2	1,214,890	1,214,890
3 Rezerva të tjera	26.3		
▶ Fitimi i pashpërndarë	27	20,000,000	
▶ Fitim / Humbja e Vitit	28	117,894,129	71,488,796
Totali i Kapitalit		222,109,019	155,703,686
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT		411,271,295.0	315,139,767

Fitimet gjendje me 31.12.2021 per shumen 137,894,129 leke,nga verifikimet e kryera,ekzistojne realisht dhe kane nje kunderparti reale ne aktivin e bilancit te shoqerise qe ploteson kerkesat ligjore per zmadhimin e kapitalit themeltare te shoqerise “Alba Skela Construction “shpk Tirane ,

Per ekzistencen e ketij fitimim gjendje me 31.12.2021 si dhe mbulimin e tij me aktive afatgjata materiale dhe ato qarkulluese kam krijuar bindjen, pervec verifikimeve te nevojshme qe kam bere dhe me raportin e auditit te leshuar per kontrollin e llogarive per vitin 2021,raport ky i leshuar pa shprehur rezerva .

Fitimet e vitit ushtrimore si dhe ato gjendje me 31.12.2021 per shumen 137,894,129 leke,jane kontribut i ortakut te vetem te shoqerise dhe do te zoterohen 100 % nga ai .

Zmadhimi I kapitalit ne shumen 30,000,000 leke mbeshtet ne fitimin neto te realizuar pergjate periudhes ushtrimore 2021 si dhe ate gjendje me 31.12.2021.Mbas kesaj shtese te kapitalit themeltare,fitimi I ushtrimit dhe ai gjednje me 31.12.2021 ne shumen 137,894,129 leke perdoret per zmadhim te kapitalit themeltare te shoqerise per 30,000,000 leke per shtim te rezerves ligjore ne vleren 2,000,000 leke ,dhe shperndarje dividenti ne vleren 105,894,129 .

Zoterimi i Kapitalit Themeltare pas kesaj shtese, nga 83,000,000 leke (vlera para zmadhimit te kapitalit)ne 113,000,000 leke (njqinde e trembedhjete milion),behet nga ortaku i vetem i shoqerise si me poshte :

1- Z.Mark Ndoj 100 % te Kapitalit Themeltare e barabarte

a. Kapital ne para 113,000,000 leke

Ndryshimet ne kapital pas Zmadhimit :

Kapitalet e Veta	Pas Zmadhimit	Para Zmadhimit
Kapitali	113,000,000	83,000,000
Rezerve Ligjore	2,000,000	
Rezerva Statutore	1,214,890	1,214,890
Fitime te pa shperndara	0	20,000,000
Fitimi i vitit ushtrimore 2021	0	117,894,129
Totali i Kapitalit	116,214,890	222,109,019

Ndryshimet si me siper do te pasqyrohen ne pasqyrat financiare te vitit ushtrimore 2022.

Ky raport ka realizuar misionin e tij .

Ne vijim te procedurave te kryera konstatoje se :

Vendimi i ortakut te vetem te shoqerise per zmadhimin e kapitalit te shoqerise nepermjet perfshirjes ne te, te nje pjese te fitimit neto te realizuar ne ushtrimin e mbyllur me 31.12.2021, vjene si rezultat :

Fitimi neto ne vleren 137,894,129 leke egziston realisht dhe ka nje kunderparti reale ne aktivin e bilancit.

Pas verifikimit te te gjithë procesit dhe dokumentacionit te pershkruar me siper mbi bazen e te cilit eshte bere vleresimi i fitimit neto te vitit ushtrimore 2021 si dhe te atij gjendje me 31.12.2021, paraqes opinionin tim si vijon;

- 1. Vendimi i ortakut te vetem eshte i drejte dhe i bazuar ne ligj .**
- 2. Kapitali i shoqerise nga 83,000,000 leke pas zmadhimit shkone ne 113,000,000 leke .**
- 3. Kapiatli perbehet nga nje kuote dhe zoterohet teresisht nga Zoti Mark Ndoj.**
- 4. Kapitali perbehet nga Kapital ne para ne shumen 113,000,000 leke.**
- 5. Raporti i paraqitur prej meje mund te miratohet nga shoqeria dhe te kalohet per kryerjen e veprimeve te metejshme ne Qendren Kombetare te Biznesit.**

Auditues Ligjor

Erminda Gjondeda Lic Nr 312

Tirane 29.08.2022

